



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA IV

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. 34

Prishtinë, më 18.11.2011, ora 11,00

Ndërtesa e Kuvendit, sala N-303

**PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT**

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, Liburn Aliu, Rasim Demiri, Nijazi Idrizi, Salih Morina, Sevdije Lama, Afërdita Berisha-Shaqiri, Etem Arifi, Daut Haradinaj.

Të ftuar dhe pjesëmarrës tjerë: zyrtar nga MB dhe MMPH me dy ministra, bashkëpunëtor, përfaqësues dhe vëzhgues të interesuar (KDI, OSBE), media.

Stafi mbështetës i komisionit: Bajram Badivuku, Ylber Sherifi.

Mbledhjen e kryesoi **Nait Hasani**, kryetar i komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. **Miratimi i rendit të ditës ,**
2. **Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së komisionit, të mbajtur më 16.11.2011,**
3. **Shqyrtimi i Projekt buxhetit për vitin 2012 për dy ministri në fushën e këtij komisionit ,**
4. **Të ndryshme.**

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 16.11.2011

Kryetari konstatoi se Komisioni miratoi Procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 16.11.2011.

3. Takimi me ministrin e mjedisit dhe të bujqësisë lidhur me projekt buxhetin e vitit 2012

Nait Hasani përshëndeti dy ministrat dhe konstatoi miratimin e buxhetit në parim në mbledhjen e djeshme plenare, mirëpo siç tha ai kjo nuk mjafton sa i përket bujqësisë dhe mjedisit, ngase ky komision tani duhet të detalizoi hapat e mëtejme për të plotësuar këtë ligj ku është nevoja.

Dardan Gashi ministër, falënderoi për mbështetje nga deputetët dhe sqaroi në detale nevojat reale të departamenteve në MMPH duke krahasuar me atë çka është shkruar në projektin e miratuar dje në parim. Në kuadër të nevojave buxhetore ai i përmendi edhe 120.000 euro të cilat nevojiten për Bordin Mjedisor dhe dy agjencione për vitin vijues. Ai konstatoi se në fund të vitit deputetët do të njoftohen me shkrim me matricën detale sa i përket shpenzimeve që janë bërë dhe shpenzimeve që duhet bërë gjatë vitit 2012, por fatkeqësisht gjysma do të mbeten teori ngase mjedisi meriton dhe i duhen shumë më tepër sesa që është ndarë me këtë projekt buxhetor.

Liburn Aliu në vazhdim pyeti për mosrealizimin e projekteve dhe kërkoi mjaft sqarime për shumë projekte të ministrisë duke shkuar radhazi sipas projektit duke konstatuar se realizimin 50% të një projekt e kupton, por për realizimin vetëm 4% ose 0% pyeti a do të thotë se ka ngec ai projekt. Sekretari i MMPH dhe ministri sqaruan se projektet që nuk kanë mbaruar barten në vitin vijues dhe bëhet pastaj barazimi i obligimeve, njëherit japën sqarime për secilin projekt veç e veç dhe potencuan se në fund të vitit do të epen cifrat e ndryshuara në tërësi prej atyre të tanishme.

Salih Morina u interesua për shpronësimet në shumë prej 5.6 milion dhe pyeti pse Qeverisë i kthehen mjetet nga ministria të cilat teprojnë, ngase ato mund të përdoren për shumë gjëra tjera si p.sh. për Mirushën etj. Ai ishte i mendimit që shumë mjete mund ti barten edhe trashëgimisë kulturore, ndërsa sekretari dha sqarim se mjetet e kursyera kthehen i Qeverisë, jo tjerat. Për Mirushën tha se është hartuar plani konkret i cili duhet dhe pritet të zbatohet, ndërkaq për shpronësime tha se janë në nivel nacional, ndërkaq shpronësimet p.sh. të Hades i takojnë KEK-ut.

Sevdije Lama pyeti rreth fotografimeve ajrore për çka tha se mund të participojnë edhe komunat, por ministri u përgjigj se duhet të dihet a dëshiron këtë komuna e caktuar.

Nijazi Idrizi ishte i mendimit se projekt buxheti nuk i ka prioritetizuar disa projekte të rëndësishme të cilat janë të gatshme për aktivizim dhe kanë mbetur për të ardhmen p.sh. sa është potenciali i ujërave ku mund të gjenerohen shumë vende të punës, fermerët kanë mjaft probleme me ujitje, veçanërisht tani kur kemi pak të reshura në sezonin kur duhet lagështi. Kjo mënyrë e administrimit feudal nuk është e qëndrueshme, konstatoi. Ky buxhet duhet të krijojë risi sa i përket ndarjes, ngase gjendja aktuale kërkon risi në aspektin pozitiv-diçka më mirë. Ministri konstatoi se projektet në të ardhmen do të kërkojnë bashkëfinancim, ndërsa projektet e Qeverisë janë prioritare.

Daut Haradinaj (me shaka) konstatoi se është i kënaqën me këtë administrim feudal dhe pyeti për sqarime shtesë për kanalizimin në Deçan, Ligjin për Prishtinën etj, për çka ministri premtoi se do të vazhdojnë projektet aty ku kanë mbetur.

Ministri i MMPH u largua nga takimi ndërkaq ministri **Blerand Stavileci** falënderoi për mbështetjen e deputetëve dhe i ftoi në bashkëpunim në çdo kohë, sidomos sa i përket shënimeve buxhetore të cilat do të ndryshojnë në mënyrë drastike deri në fund të vitit, për çka edhe kjo ministri angazhohet që këtij komisioni ti dërgoj ato me shkrim në mënyrë shumë detale, deri në fund të vitit. Gjatë vitit 2012 ministria e bujqësisë në total parashihet ti ketë 25 milion euro (falë edhe donacioneve), mirëpo AVUK bashkërisht duhet të bisedohet që të kthehet aty ku e ka vendin, në MB, në mënyrë që në afatin optimal kjo ministri të arrij aty ku synon : të përfshihet me 3% në buxhetin shtetërorë. Konsolidim të konsiderueshëm në këtë drejtim do të jap edhe sistemi statistikor ku do të publikohen gjërat qartë, pastaj edhe do të orientohen synimet ashtu si duhet. Grandet hyjnë në subvencione, vazhdoi, por synimi duhet të jetë që ato të orientohen në investime kapitale për të kontribuar p.sh. në projektin më të madh që synon kjo ministri : ndërtimi i qendrave grumbulluese, depove për ruajtje etj.

Daut Haradinaj kërkoi angazhim nga ministria për informim sa më të mirë të përfituesve që mund të janë, të këtyre investimeve-programeve. Ministri premtoi lidhur me këtë, por edhe rikujtoi se duhet të kemi më të lartë buxhetin, gjithnjë duke pasur parasysh mundësitë reale.

Lidhur me hidroekonomi (Nijazi Idrizi), ministri tha se nuk e kemi mirë të definuar ngase është e ndarë, nuk e ka rolin e caktuar, duhet të rregullohet sidomos pjesa e strukturimit.

Nijazi Idrizi u ndërlihdh dhe konstatoi si vijon : 1. AVUK duhet të reformohet, ti kthehet MB-së, 2. Institutit bujqësor të Pejës duhet ti epet tretmani që e meriton ngase është lënë jashtë institucioneve mësimore me çka nuk mund të kontribuoj sa duhet, dhe 3. Investimet me para të janë me efekt. Është e dhimbshme investimi për mirëqenie sociale të fermerëve tha ai dhe në fund u interesua për pyllëzime të cilat nuk dihet se a kanë mbijetuar 10% nga ato të mbjellura. Ministri sqaroi se ka bërë kërkesa lidhur me këto brenga të deputetit duke konstatua se Universiteti bënë hulumtime, ndërsa Instituti këto hulumtime mundohet me i zbatua. MB do të ketë departamentin e shërbimeve këshillimore me divizionin e statistikave, divizionin e analizave për bujqësi dhe divizionin e evaluimit dhe monitorimit, ndërsa për pyllëzime tha se do të bëhen aty ku japin efektin e tyre.

Nait Hasani rikujtoi bashkëpunimin që duhet të ketë ministria me fakultetin e bujqësisë dhe AVUK, për çka ministri potencoi se ky bashkëpunim do të bëhet përmes fondit për fakultet dhe një fondi të veçantë-të donacioneve. Diskutimet në vazhdim u fokusuan në realizimin e projekteve të ndryshme por përmes planeve konkrete, shumica u pajtuan p.sh. të orientohet më parë ministria në subvencionimin e qumështit sesa në subvencionimin e krerëve, dmth direkt të subvencionohet produkti.

Afërdita Berisha ishte i mendimit se ministria e ka tepër të ultë buxhetin nëse mirën parasysh gjërat që u diskutuan në këtë takim, ndaj roli i komisionit është të konstatoi a duhet bëhet kërkesë shtesë për rritje të buxhetit.

Liburn Aliu konstatoi se raporti i progresit është i njëanshëm, ndaj komisioni ka nevojë të informohet më detalisht nga ministria, gjithashtu insistoi për sqarime edhe të detaleve tjera.

Nait Hasani kërkoi mirëkuptim nga Liburn Aliu dhe konstatoi se në takimet tjera duhet të kontribuohet përmes diskutimeve të barabarta të anëtarëve të komisionit, jo të dominojnë disa apo vetëm një deputet. **Afërdita Berisha** konstatoi se qëllimet e diskutimeve në këtë takim ishin pozitive, kurse **Liburn Aliu** konstatoi përgjegjësinë e deputetit ndaj votuesit, ndaj duhet të kërkohej sa më shumë sqarime për të arsyetuar punën në Kuvend.

Nait Hasani konstatoi se mbledhja e sotme nuk ishte e mjaftueshme për të marr të gjitha informacionet e duhura ndaj falënderoi ministrin i cili premtoi se shënimet e kompletuara dhe të detalizuara do të dërgohen këtij komisioni pas një muaji, gjithashtu ftoi komisionin në çdo kohë për të marr informata në ministrinë e bujqësisë .

4. Të ndryshme

Në kuadër të pikës të ndryshme komisioni shqyrtoi dhe vendosi si vijon :

- I. MIRATOHET plani i veprimit të Kuvendit të Kosovës lidhur me Integrimet evropiane.
- II. MIRATOHET raporti me rekomandime i raportuesit Nijazi Idrizi lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit për tokën bujqësore.
- III. MIRATOHET fillimi i mbikëqyrjes së zbatimit të Ligjit për VSM.
- IV. Shqyrtimi i projektligjit për mbeturina, pas miratimit të afatit shtesë për shqyrtim, do të pasoj me caktimin e ekspertit përkatës.
- V. MIRATOHET raporti me rekomandime i raportuesit Nijazi Idrizi, i rekomandohet Kuvendit të Kosovës miratimi i projektligjit për rregullimin e tokës me amendamentet si vijon :

Amendamenti 1

Neni 1, riformulohet :

Qëllimi

Qëllimi i këtij Ligji është krijimi i bazës ligjore për ndërmarrjen e masave dhe veprimeve në baza vullnetare për krijimin e parcelave më të mëdha dhe rregullimin e tokave bujqësore, pyjeve dhe tokave pyjore në funksion të shfrytëzimit më racional dhe më ekonomik.

Amendamenti 2

Neni 2, riformulohet :

Fusha e zbatimit

Me këtë ligj përcaktohen përgjegjësitë e institucioneve që janë kompetente për rregullimin e tokës, procedurat për rregullimin e tokës, planifikimi, financimi dhe zbatimi i këtij procesi.

Amendamenti 3

Në këtë nen hiqet fjala “nënkupton” tek përkufizimet ku përfshihet në fillim.

Thonjëzat hiqen në çdo fjalë në fillim të përkufizimit.

Neni 3, pas përkufizimit 1.4 shtohet përkufizimi si vijon :

1.5 Pjelloria e tokës – është aftësia natyrore e tokës për sigurimin e njëkohshëm të ujit dhe të elementeve ushqyese për bimë dhe krijimi i kushteve të përshtatshme fizike dhe biokimike për to.

Te pika 1.12 “parcela e tokës” bëhet “parcela kadastrale” si dhe në tërë tekstin ku është fjala “ngastra” bëhet “parcela”.

Amendamenti 4

Neni 4, riformulohet :

Qëllimi i Rregullimit

1. Rregullimi i tokës bëhet për këto qëllime:

1.1 Grupimi i tokës për shfrytëzim më racional dhe ekonomik,

1.2 krijimi i ngastrave me formë të rregullt gjeometrike;

1.3 Përmirësimin e tokës përmes zbatimit të masave agro-teknike, agro-melioruese dhe hidro-melioruese;

1.4 Përmirësimi i infrastrukturës duke përfshirë qasjen në infrastrukturën publike;

1.5 Ripyllëzimi i tokës të cilësisë më të dobët ose tokës së ndotur;

1.6 Matjet e reja të tokës;

1.7 Krijimi i kadastrës së re.

Amendamenti 5

Neni 5, riformulohet :

Masa e Rregullimit të Tokës

1. Ministria në harmoni me Planin Zvillimor Komunal propozon zonat kadastrale apo pjesët e zonave kadastrale të cilat do të rregullohen me projektin e rregullimit të tokës.

2. Rregullimi i tokës nga paragrafi 1 i këtij neni nuk mund të zbatohet nëse nuk është miratuar Plan Hapësinor i Komunës.

Amendamenti 6

Neni 6, riformulohet :

Pjesëmarrësit në rregullimin e tokave

1. Në rregullimin e tokës marrin pjesë:

1.1. Të gjithë pronarët e tokave;

1.2. Të gjithë pronarët me të drejta sendore, hipoteka dhe servitute brenda kufijëve të masës së propozuar të rregullimit të tokave.

Amendamenti 7

Neni 7, riformulohet :

Komisioni për rregullimin e tokës

1. Komisionin për Rregullimin e Tokës e emron Ministria për çdo projekt të aprovuar të rregullimit të tokës.
2. Komisioni për Rregullimin e Tokës përbëhet prej pesë anëtarëve të cilë i emron Ministria.
 - 2.1. Tre anëtarë i propozon Komuna, dy anëtarë i propozon këshilli i pjesëmarrësve.
3. Komisioni për Rregullimin e Tokës është përgjegjës për tërë projektin e rregullimit të tokës, hatrimin e planeve, zbatimin dhe të gjitha procedurave të tjera përkatëse.
4. Ministria me akt nënligjor e rregullon:
 - 4.1. Përbërjen e Komisionit për Rregullimin e Tokës;
 - 4.2. Procedurat e tij;
 - 4.3. Mbledhjet;
 - 4.4. Kompensimin;
 - 4.5. Përgjegjësitë;
 - 4.6. Punët administrative dhe teknike.

Amendamenti 8

Neni 8, riformulohet :

Institucionet përgjegjëse në rregullimin e tokës

1. Institucionet që mbështesin Komisionin për rregullimin e tokës janë:
 - 1.1. Ministria;
 - 1.2. Agjencia Kadastrale e Kosovës;
 - 1.3. Komuna;
 - 1.4. Zyra kadastrale komunale.
2. Agjencia Kadastrale e Kosovës dhe Zyra Kadastrale Komunale siguron të dhënat e nevojshme në pajtim me Ligjin për Kadastër dhe mbështesin Komisionin në përpilimin e projektit për rregullimin e tokës.
3. Komuna ofron ndihmë teknike administrative Komisionit për Rregullimin e Tokës
4. Ministria e këshillon, mbështet dhe mbikqyr Komisionin për Rregullimin e Tokës.

Amendamenti 9

Neni 9, riformulohet :

Rastet kur nuk mund të bëhet rregullimi i tokës

1. Rregullimi i tokës nuk mund të bëhet kur:
 - 1.1. grupimi i propozuar i tokës së përfshirë në projekt nuk është në harmoni me legjislacionin në fuqi;
 - 1.2. shpenzimet e projektit nuk janë në proporcion me përfitimet dhe interesat të cilat priten nga rregullimi i tokës.

Amendamenti 10

Neni 10, riformulohet :

Kërkesa për rregullimin e tokës

1. Kërkesa për zbatim të rregullimit të tokës parashtrohet nga:
 - 1.1. Dy e treta e numrit të pronarëve të tokave nga zona e propozuar për rregullimin e tokës;
 - 1.2. Komuna në territorin ku gjendet masa për rregullimin e tokës;
 - 1.3. Më shumë se një komunë kur masa e propozuar e rregullimit të tokës gjendet në territorin e tyre;
 - 1.4. Ndërmarrjet publike;
 - 1.5. Shoqatat e fermerëve;
 - 1.6. Organizatat jo qeveritare të pyejeve dhe tokave
 - 1.7. Kooperativat bujqësore në emër të pronarëve të bashkuar në kooperativë bujqësore.
2. Kërkesa për projektin e rregullimit të tokës i dorëzohet Ministrisë.
3. Kërkesa për rregullim të tokës përmban:
 - 3.1 Propozimin për kufij të masës së rregullimit të tokës;
 - 3.2 Arsyeshmërinë për rregullim të tokës;
 - 3.3 Numrin e pjesëmarrësve;
 - 3.4 Mjetet financiare.
4. Kërkesën Për rregullimin e tokës e miraton Ministria dhe emron Komisionin për Rregullimin e Tokës në bazë të nenit 7 të këtij ligji.
5. Ministria inicon rregullimin e tokës në mënyrë të pavarur, vendimi i Ministrisë duhet të përfshijë të gjitha informatat e domosdoshme mbi projektin e rregullimit të tokave, në bazë të paragrafit 3 të këtij neni.
6. Miratimi i kërkesës për rregullimin e tokës shpallet në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në tabelën e shpalljeve të Kuvendit Komunal.

Amendamenti 11

Neni 11, riformulohet :

Përmbajtja e projektit për rregullimin e tokës

1. Ministria përmes operatorit ekonomik harton projektin e rregullimit të tokës.
2. Projekti për rregullimin e tokës përmban këto të dhëna:
 - 2.1. Kufijtë e saktë të masës së rregullimit të tokës;
 - 2.2 Të dhënat e tokës e cila nuk këmbëhet;
 - 2.3 Informatat lidhur me përmirësimin dhe ndryshimet në infrastrukturë duke përfshirë qasjen në rrugët e reja dhe sistemin e ujitjes;
 - 2.4. Mundësitë dhe kushtet për të paraqitur tokën e nevojshme për interes të përgjithshëm bazuar në kontributin vullnetar të pjesëmarrësve;
 - 2.5. Buxhetin e detajuar për zbatim të projektit për rregullimin e tokës duke përfshirë shpenzimet e paraqitura nga pjesëmarrësit dhe mënyrën e pagesës;
 - 2.6. Të dhënat mbi mjetet e investuara dhe të planifikuara për punët e meliorimit dhe punët tjera teknike;
 - 2.7. Të dhënat e përgjithshme për rregullim të tokës të cilat janë:
 - a). Zonat kadastrale;
 - b). Sipërfaqja e tokave sipas kulturave;
 - c). Numri i parcelave kadastrale;
 - ç). Numri i pjesëmarrësve.
 - 2.8. Të dhënat tjera të përcaktuara në udhëzuesin për rregullim të tokës të specifikuar në projekt.
3. Ministria nxjerr akte nënligjore për raste specifike, të përcaktuara me paragrafin 2 të këtij neni.

Amendamenti 12

Neni 12, në paragrafin 5, pas fjalisë së parë në reshtin e parë “Pas shqyrtimit publik” shtohet “dhe inkorporimit të vërejtjeve të arsyeshme”.

Amendamenti 13

Neni 16

Masat meliorative për rregullimin e tokës

1. Masat meliorative për rregullimin e tokës janë:

1.1 ndërtimi dhe mirëmbajtja e sistemit të ujitjes dhe kullimit;

1.2 meliorimi i livadheve dhe kullotave;

1.3 kthimi i tokës së pa punueshme në tokë të punueshme;

1.4 përmirësimi i cilësisë dhe vetive të tokës bujqësore përmes kalcifikimit, humusimit, kullimit, shkrypizimit, plehrit meliorativ, rikultivimit të tokave të dëmtuara dhe të degraduara.

1.5 masat tjera të rregullimit të tokës.

Amendamenti 14

Neni 34, titulli bëhet “**Sqarimi i pronësisë**”.

Mbledhja e komisionit përfundoi në orën 15,00.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit,

Nait Hasani